

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. BOE BIBA-X shpk & PE-VLA-KU shpk NIPT K32618815N & K61716013M

(marreveshje bashkepunimi 50% me 50%)

Vlera 211,580,672.10 (dyqind e njembedhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtë shtatëdhjetë e dy pike dhjetë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. 2 Z KONSTRUKSION shpk NIPT J63229466K

Vlera 233,118,098 (dyqind e tridhjetë e tre milion e njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e nentëdhjetë e tete) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. FUSHA shpk NIPT J61922018S

Vlera 208,027,748.25 (dyqind e tete milion e njëzet e shtate mijë e shtatëqind e dyzet e tete pike njëzet e pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk NIPT L78006801F& J61902509S

(marreveshje bashkepunimi 90% me 10%)

Vlera 197,735,685 (njëqind e nentëdhjetë e shtate milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë gjashtëqind e tetëdhjetë e pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. BOE LIQENI VII shpk & MAKARESH shpk NIPT K01730502W & K24725213C

(marreveshje bashkepunimi 95% me 5%)

Vlera 196,380,292.50 (njëqind e nentëdhjetë e gjashtë milion e treqind e tetëdhjetë mijë dyqind e nentëdhjetë e dy pike pesëdhjetë) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

7. BOE RAFIN COMPANY shpk & DRINI-1 shpk NIPT L52125110A&J78716317H

(marreveshje bashkepunimi 94,3% me 5,7%)

Vlera 218,615,880 (dyqind e tetembedhjete milion e gjashtëqind e pesembedhjete mije e tetëqind e tetedhjete) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

8. VELLEZERIT HYSA shpk NIPT K12911201C

Vlera 239.635.016.25 (dyqind e tridhjete e nente milion e e gjashtëqind e tridhjete e pese mije e gjashtëmbëdhjetë pike njëzet e pese) lekë pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. BOE BIBA-X shpk & PE-VLA-KU shpk NIPT K32618815N & K61716013M

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Bashkimi i operatoreve “**BIBA-X shpk & PE-VLA-KU shpk** u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk ka shfaqur mangësi gjatë hartimit të ofertës ekonomike dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Gjatë shqyrtimit të ofertës ekonomike të BOE BIBA X shpk dhe PE VLA KU shpk konstatohen këto mangësi:

- Operatori ekonomik BIBA-X shpk gjatë hartimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit ka deklaruar tek “PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK” emrin e operatorit ekonomik vetëm veten, ndërkohë që janë bashkim operatorësh ekonomikë.
- Operatori ekonomik PE-VLA-KU shpk gjatë hartimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit ka deklaruar tek “PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK” emrin e operatorit ekonomik vetëm veten, ndërkohë që janë bashkim operatorësh ekonomikë.
- BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk nuk kanë deklaruar në marrëveshjen e bashkëpunimit se cili prej anëtarëve të bashkimit do të përmbushë pikën 5 të nenit 39 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” në të cilin thuhet “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka

përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”. Në rastin konkret Autoriteti Kontraktor është në dilemë për plotësimin e kërkesës së pikës 2.3.1.a nga BOE.

2. BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU **shpk** nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për pajisjen me leje mjedëre kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik **BIBA-X** merr përsipër realizimin e 50% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik **PE-VLA-KU shpk** merr përsipër realizimin e 50% të tyre.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe në faqën e internetit qkb.gov.al, konstatohet se operatori ekonomik **BIBA-X** nuk posedon leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme.

3. **BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk** nuk plotësojnë pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht: Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime) e vlefshme/ose ekuivalent, Certifikata të jete lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën E sipas punimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit (në rastin konkret zërat (tubacione HDPE dhe Tombino betoni) që lidhen me objektin e certifikatës sipas preventivit).

Nga verifikimi i dokumentacionit të **BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk**, selici prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh kanë paraqitur certifikatën ISO 1452-1:2009 të lëshuar nga organizmi certifikues AQScert shpk. Nga verifikimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithme të Akreditimit konstatohet se organizmi certifikues AQScert shpk nuk është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit.

Nga sa më lart, certifikatat e paraqitura nga **BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk nuk janë të vlefshme.**

4. **BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk** nuk plotëson pikën 2.3.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 2 (dy) hidraulikë.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik **BIBA-X shpk** merr përsipër realizimin e 50% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik **PE-VLA-KU shpk** merr përsipër realizimin e 50% të tyre.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **BIBA-X shpk** dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **BIBA-X shpk** konstatohet se operatori ekonomik **BIBA-X shpk** nuk ka deklaruar se ka në stafin e tij punonjës të specializuar hidraulikë.

5. BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk nuk plotëson pikën 2.3.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin e stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 10 (dhjetë) Manovrator dhe 10 (dhjetë) Shofere..

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik BIBA-X shpk merr përsipër realizimin e 50% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik PE-VLA-KU shpk merr përsipër realizimin e 50% të tyre.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **BIBA-X shpk** konstatohet se ka deklaruar se ka në dispozicion 3 (tre) Shofere nga 5 (pesë) që i nevojiten.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik PE-VLA-KU shpk konstatohet se ka deklaruar se ka në dispozicion 3 (tre) manovratorë nga 5 (pesë) që i nevojiten.

Shoferët dhe manovratorët e deklaruar të shoqërive mbështetëse BIMAK shpk dhe PE-VLA-KU shpk dega Kosovë janë të pavlefshëm, referuar ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

6. BOE BIBA-X shpk dhe PE-VLA-KU shpk nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht për 5 (pesë) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton; 5 (pesë) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton; 4 (katër) rul kompresor me vibrim gome-cilindër mbi 10 ton, 4 (katër) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton, 2 (dy) rul kompresor me vibrim cilindër-cilindër 6-10 ton, 2 (dy) rul gome-gome mbi 8 ton, 1 (një) rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik **BIBA- X** merr përsipër realizimin e 50% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik **PE-VLA- KU shpk** merr përsipër realizimin e 50% të tyre.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **BIBA-X shpk** konstatohet se ka deklaruar se ka në dispozicion:

- Asnjë kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten
- 1 (një) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten
- Asnjë rimorkiator për levizjen e mjeteve që nuk lëvizin vetë në rrugë nga minimumi 1(një) që i nevojiten

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **PE-VLA-KU shpk** konstatohet se ka deklaruar se ka në dispozicion:

- Asnjë rul kompresor me vibrim gome-cilindër mbi 10 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten
- Asnjë rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten
- Asnjë rul kompresor me vibrim cilindër-cilindër 6-10 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten
- Asnjë rul gome-gome mbi 8 ton nga minimumi 2(dy) që i nevojiten

2. 2Z KONSTRUKSION shpk

NIPT J63229466K

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “**2Z KONSTRUKSION “shpk**” u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 në vlerën e përcaktuar në Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike të DST me të njëjtin objekt.
2. **Nuk është llogaritur fondi rezervë**
3. Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të kritereve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk ka paraqitur dokumentacion për 2 (dy) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme. Konkretisht:

- **Rikonstrukcion I rrugës Mirakë – Gjovac, NJA Polis**, vlera 39,000,074 lekë pa tvsh nga të cilat shoqëria 2Z Konstruksion shpk do të realizojë 49.87% të punimeve ose 19,449,337 leke pa tvsh.
- **Sistemim asfaltim I rrugës së fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, NJësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd**, vlera 59,238,031 lekë pa tvsh nga të cilat shoqëria 2Z Konstruksion shpk do të realizojë 50% të punimeve ose 29,619,015 leke pa tvsh.

Nisur nga sa me sipër, operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk nuk ka kontratë të vetme për përmbushjen e kërkesës së Autoritetit Kontraktor referuar pikës 2.3.1.a “ punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Gjithashtu vlera totale e kontratave me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit është më e vogël dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

4. Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk nuk plotëson pikën 2.3.4 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin e fuqisë mesatare punëtore për mesatarisht 67 (gjashtëdhjetë e shtate) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën **Janar - Mars 2026**, i lëshuar nga Administrata Tatimore

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve object kontrate” operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk ka deklaruar se disponon minimalisht 20 (njëzet) punonjës të figuruar në lispagesat e 3 muajve të fundit.

5. Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, ”Sistemi i Menaxhimit të Energjisë” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
- Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 39001:2012** “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së trafikut rrugor” e përditësuar, e vlefshme/ekuivalent.
- Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime) e vlefshme/ose ekuivalent, Certifikata të jete lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas punimeve të marra përsipër në marrvëshjen e bashkëpunimit (në rastin konkret zërat (tubacione HDPE dhe Tombino betoni) që lidhen me objektin e certifikatës sipas preventivit).

Operatori ekonomik 2Z Konstruksion shpk në formularin përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se tek Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT në Seksionin A DEKLARATË ”Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” deklaroi se zotëron certifikata ISO të llojit:

- Çertifikatë ISO 9001:2015 Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë
- Çertifikatë ISO 45001:2018 Menaxhimi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- Çertifikatë ISO 14001:2015 Sistemet e Menaxhimit Mjedisor

Gjithashtu nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur, janë dokumentuar vetëm tre certifikatat ISO të listuara më sipër.

3. FUSHA shpk

NIPT J61922018S

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Operatori ekonomik “Fusha” shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si më poshte:

1. Operatori ekonomik Fusha shpk nuk plotëson pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht: Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime) e vlefshme/ ose ekuivalent, Certifikata të jete lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën E sipas punimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit (në rastin konkret zërat (tubacione HDPE dhe Tombino betoni) që lidhen me objektin e certifikatës sipas preventivit).

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Fusha shpk, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës Shansi Invest shpk dhe Akt Marrëveshjen e lidhur midis tyre, konstatohet se operatori ekonomik mbështetës Shansi Invest shpk do të mbështetë me Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime).

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

Nisur nga sa më sipër dhe referuar Akt Marrëveshjeve të operatorit ekonomik Liqeni VII shpk me operatorët ekonomikë mbështetës Shansi Invest shpk, konstatohet se në asnjë moment operatori ekonomik mbështetës nuk merr përsipër të kryejnë vetë punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

2. Operatori ekonomik Fusha shpk nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për pajisjen me leje mjedisore kodit III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në SPE, Akt Miratimi, konstatohet se lloji i mbetjeve të listuara për të cilat i lejohet të grumbullojë dhe transportojë, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

4. BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk NIPT L78006801F& J61902509S

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotësonte të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. **BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk** nuk plotëson kushtin që bashkë me marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë duhet të dorëzojë në SPE gjithashtu edhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk kanë dorëzuar marrëveshjen e nënshkruar midis tyre, në të cilën është ndarë vetëm përqinja e pjesëmarrjes së tyre, por nuk kanë dokumentin që përcakton zërat e unimeve që do të realizojë secili prej tyre.

Referuar nenit 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” në të cilin thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”, mosplotësimi I kësaj kërkesë bën të pamundur shqyrtimin e kapaciteteve ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike që do të përmbushë secili anëtar I BOE.

2. **BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk** shpk nuk plotëson pikën 2.3.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 1 (një) teknik topograf/ gjeometër.

Referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE të **BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk** nuk është deklaruar se kanë në dispozicion 1 (një) teknik topograf/ gjeometër dhe as nuk është paraqitur ndonjë document për ta vertetuar këtë.

3. **BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk** shpk nuk plotëson pikën 2.3.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 10 (dhjete) Manovrator dhe 10 (dhjetë) Shofere.

Referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të paraqitur në SPE, operatori ekonomik L.T.E CONSTRUCTION shpk ka deklaruar se ka në dispozicion 7 (shtatë) manovratorë nga 9 (nëntë) që i nevojiten dhe 4 (katër) Shofere nga 9 (nëntë) që i nevojiten.

4. **BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk** nuk plotësojnë pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të përcaktuar në DT për paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht: Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime) e vlefshme/ ose ekuivalent, Certifikata të jete lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të operatoreve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën E sipas punimeve të

marra përsipër ne marrveshjen e bashkëpunimit (ne rastin konkret zërat (tubacione HDPE dhe Tombino betoni) qe lidhen me objektin e certifikatës sipas preventivit).

Nga verifikimi I dokumentacionit të BOE L.T.E CONSTRUCTION shpk & VARAKU E shpk , asnjëri prej anëtarëve të ketij bashkimi operatorësh nuk e posedon këtë certifikatë.

5. BOE LIQENI VII shpk & MAKARESH shpk NIPT K01730502W & K24725213C

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

BOE LIQENI VII shpk & MAKARESH shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.2.2 të kriterëve te veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për paraqitjen e kopjeve të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika "c", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Konkretisht operatori ekonomik Makaresh shpk nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2024. Duke qenë se bilancet e viteve 2023 dhe 2025 nuk janë të njëpasnjëshme, atëherë kërkesa për dy bilance të njëpasnjëshme që nuk kanë raport negativ është e pamundur.

2. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve te veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Operatori ekonomik **Makaresh shpk** merr përsipër realizimin e 5% të punimeve objekt I kontratës, I përkthyer në vlerë 6,240,113 lekë pa tvsh për plotësimin e pikës 2.3.1.a ose 24,960,452 lekë pa tvsh për plotësimin e pikës 2.3.1.b.

Operatori ekonomik Makaresh shpk ka paraqitur dokumentacion për 2 (dy) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme. Konkretisht:

- Furnizim me inerte dhe punime me makineri për nivelim me beton+asfalt për parkim me vlerë 5,714,400 lekë pa tvsh. Theksojmë se natyra e kësaj kontrate, nëse I referohemi faturave tatimore të paraqitura nga operatori ekonomik në SPE, është furnizimi me materiale ndërtimi (cakull, stabilizant), transport I këtyre materialeve dhe punime ngjeshje. Gjithashtu ka mospërputhje në përshkrimin e zerave objekt i kontratës, situacionit përfundimtar dhe faturave tatimore.

Pervec fakteve të mësipërme, vlera e kësaj kontrate nuk përmbush kushtin e percaktuar në pikën 2.3.1.a të kërkesave të vecanta të kualifikimit.

- Sistemim i Sheshit i Objektit (5 Kapanone Industriale 3Kat me MurRrethues,Kabinë Roje dhe Kabinë Elektrike”.Në Rrashbull,Durrës.

Kjo kontratë ka disa mospërputhje të cilat e bëjnë atë të pavlefshme, konkretisht:

1. Objekti I lejes së ndërtimit dhe lejes së zhvillimit nuk përputhet me objektin e kontratës së lidhur midis shoqërisë Desla shpk dhe Makaresh shpk.
 2. Nuk vërtetohet në asnjë moment lidhja midis shoqërisë Desla shpk dhe shoqërive të përmendura në lejen e ndërtimit dhe lejen e zhvillimit.
- Mbështetur në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” pika 3, thuhet “Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.”. Nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur nga BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk konstatohet se nuk ka asnjë dokument angazhimi me shkrim të subjekteve Makaresh shpk dhe Kegli Duri shpk që vërteton këtë fakt.

Persa më sipër dhe për faktin se eksperiencia e subjekteve të tjera nuk mund të janë mbështetje për subjektet presmarrëse në një procedurë prokurimi, kontratat e ngjashme të paraqitura nga shoqëria Kegli Duri shpk si subject mbështetës janë të pavlefshme.

Operatori ekonomik Liqeni VII shpk ka paraqitur dokumentacion për 14 (katërmbëdhjetë) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme. Të gjitha kontratat kanë objekt të ngjashëm me objektin e kontratës që prokurohet. Dy kontrata janë realizuar pothuajse gjate vitit 2020 dhe fillim I vitit 2021, dmth janë më të vjetra se afati pesëvjeçar I kërkuar në DST.

Operatori ekonomik Liqeni VII shpk nuk ka paraqitur asnjë kontratë që përmbush kërkesën e pikës 2.3.1.a për kontrata në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit.

Gjithashtu, operatori ekonomik Liqeni VII shpk nuk përmbush kërkesën e pikës 2.3.1.b, duke qenë se vlera totale e kontratave të realizuar gjatë pesë viteve të fundit është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

3. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.3.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 1 (një) teknik topograf/ gjeometër.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik **Liqeni VII shpk**, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës SARDO shpk dhe Akt Marrëveshjen e lidhur midis tyre, konstatohet se operatori ekonomik mbështetës SARDO shpk do të mbështetë me 1 (një) teknik topograf/ gjeometër E.G..

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

Nisur nga sa më sipër dhe referuar Akt Marrëveshjeve të operatorit ekonomik **Liqeni VII shpk** me operatorët ekonomikë mbështetës SARDO shpk, konstatojmë se në asnjë moment

operatori ekonomik mbështetës nuk merr përsipër të kryejnë vetë punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

4. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.3.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 10 (dhjete) Manovrator dhe 10 (dhjetë) Shofere.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik Liqeni VII shpk merr përsipër realizimin e 70% të zërave të punimeve për gërmime me eskavator dhe transport material ndërtimi dheu, ndërsa operatori ekonomik Makaresh shpk merr përsipër realizimin e 30% të këture zërave. Për këtë arsye, operatori ekonomik Liqeni VII shpk duhet të ketë në dispozicion 7 (shtatë) Manovrator dhe 7 (shtatë) Shofere, ndërsa operatori ekonomik Makaresh shpk duhet të ketë në dispozicion 3 (tre) Manovrator dhe 3 (tre) Shofere.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Liqeni VII shpk dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Makaresh shpk konstatohet se operatori ekonomik Liqeni VII shpk ka 5 (pesë) manovratorë nga 7 (shtatë) që i nevojiten dhe 4 (katër) Shofere nga 7 (shtatë) që i nevojiten.

Kërkesat e pikës 2.3.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT nuk përmbushet nga **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk**

5. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për pajisjen me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik Liqeni VII shpk merr përsipër realizimin e 70% të zërave të punimeve për gërmime me eskavator dhe transport material ndërtimi dheu, ndërsa operatori ekonomik Makaresh shpk merr përsipër realizimin e 30% të këture zërave.

Nga verifikimet e dokumentacionit të paraqitur në SPE dhe në faqën e internetit qkb.gov.al, konstatohet se operatori ekonomik Makaresh shpk nuk posedon leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme.

6. **BOE Liqeni VII shpk dhe Makaresh shpk** nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht për 4 (katër) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton, 2 (dy) rul gome-gome mbi 8 ton,.

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" thuhet "Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje."

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së punime, vërejmë se operatori ekonomik **Liqeni VII shpk** merr përsipër realizimin e 94.3% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik **Makaresh shpk** merr përsipër realizimin e 5.7% të tyre.

Përsa më sipër, operatori ekonomik nuk plotëson kërkesën për mjetet që I nevojiten për realizimin e objektit të prokurimit, konkretisht ka ka 1 (një) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton nga (katër) që i nevojiten dhe nuk ka asnjë rul gome-gome mbi 8 ton nga 2 (dy) që i nevojiten.

6. **BOE RAFIN COMPANY shpk & DRINI-1 shpk** **NIPT L52125110A & J78716317H**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

BOE RAFIN COMPANY shpk & DRINI-1 shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe ekonomike si me poshte:

1. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotëson pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për shlyerjen e të gjitha taksat vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2025 dhe për vitin 2026, ku të perfshihet kesti për periudhën perkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Referuar të dhënave të Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar të operatorit ekonomik Rafin Company shpk, citohet se më datë 05.11.2025 është Shtuar Adresa: "Tirane; TIRANE; Kamez; Rruga "Berisha", Pasuria Nr. 92/116, Zona Kadastrale 2066; për realizimin e punimeve të ndërtimit me objekt kontrate: "Ndërtim i parkimit me 1 kat nëntokë, objekti 3 kat I bashkisë dhe rehabilitimi i sheshit."

Nga ana e operatorit ekonomik Rafin Company shpk nuk është paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore në Bashkinë Kamëz për vitin 2025 apo atë të vlerës së maturuar të vitit 2026.

2. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotëson pikën 2.3.1 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për të provuar përvojën e mëparshme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës apo punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Operatori ekonomik Rafin Company shpk merr përsipër realizimin e 94.3% të punimeve objekt I kontratës, I përkthyer në vlerë 117,688,531 lekë pa tvsh për plotësimin e pikës 2.3.1.a ose 470,754,126 lekë pa tvsh për plotësimin e pikës 2.3.1.b.

Operatori ekonomik Rafin Company shpk ka paraqitur dokumentacion për 8 (tetë) kontrata të lidhura me Autoritete Kontraktore të ndryshme. Konkretisht:

- Ndërtimi I parkut të mbyllur (B), për mjetet e blinduara (HMMËV), me vlerë 153,118,669 lekë pa tvsh. Objekti I kësaj kontrate nuk është I ngjashëm me objektin e prokurimit duke qenë se kjo kontratë karakterizohet nga punime si me vlerë 42,006,850 lekë pa tvsh janë Punime Mekanike, Punime Elktrike, Pajisje mekanike dhe elktrike, Punimet e Rrethimit të Jashtëm, me vlerë 3,450,786 lekë pa tvsh janë punime për Godinën e Vendkontrollit dhe me vlerë 50,899,064 lekë pa tvsh janë punime për konstruksione metalike. Vlera e punimeve të ndërtimit të ngjashme me objektin e prokurimit zënë me përafërsi 25% të vlerës totale.
- Ndërtim pedonale, pistë vrapimi dhe korsi bicikletash në liqenin e Farkës, me vlerë 494,718,322 lekë pa tvsh, nga të cilat shoqëria Rafin Company shpk do të realizojë 22% të punimeve ose 108,838,030 leke pa tvsh.
- Përmirësimi i infrastrukturës në garnizonin “Skënderbej, objekti I kësaj kontrate dhe punimet e ndërtimit që përfshin kjo kontratë, nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.
- Sistemim asfaltim I rrugës së fshatit Luz I Madh, Bashkia Rrogozhine, me vlerë 49,707,039 leke pa tvsh
- Sistemim asfaltim I bllokut të banimit ish-SMT me vlerë 6,561,689 leke pa tvsh
- Rikualifikim urban Lagjia Partizani Bllok 1 & 2, Bajram Curri me vlerë 53,717,332.5 leke pa tvsh nga të cilat shoqëria Rafin Company shpk do të realizojë 10% të punimeve ose 5,371,734 leke pa tvsh.
- Rikonstruksion I rrugës ish-thertorja, lagja 29 Marsi, me vlerë 5,903,933 leke pa tvsh
- Punime ndërtimore për ndërtimin e infrastrukturës lidhëse mes godinave të kampusit dhe shtim kapacitetit të vendparkimit në kampus, me vlerë 27,671,503 leke pa tvsh

Nisur nga sa me sipër, operatori ekonomik Rafin Company shpk nuk ka kontratë të vetme për përmbylljen e kërkesës së Autoritetit Kontraktor referuar pikës 2.3.1.a “ punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Gjithashtu vlera totale e kontratave me natyrë të ngjashme me objektin e prokurimit është më e vogël dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

3. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotëson pikën 2.3.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për disponimin stafit të tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, konkretisht për 1 (një) inxhinier ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura) dhe 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Referuar dokumentacionit të paraqitur, formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik Rafin Company shpk dhe formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të operatorit ekonomik mbështetës MVV Consulting shpk dhe Denolt shpk, konstatohet se operatori ekonomik mbështetës MVV Consulting shpk do të mbështetë me 1 (një) inxhinier ndërtimi (Profili Transport/Infrastruktura) S.K. dhe operatori ekonomik mbështetës Denolt shpk do të mbështetë me 1 (një) inxhinier topograf/gjeodet/markshajder.

Në VKM Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike,

që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” Kreu IV “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë” pika 2 paragrafi I dytë thuhet se “Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi ...”.

Në ligjin nr 162/2020 “Për Prokurimin public”, Neni 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” thuhet “Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.”

Nisur nga sa më sipër dhe referuar Akt Marrëveshjeve të operatorit ekonomik Rafin Company shpk me operatorët ekonomikë mbështetës MVV Consulting shpk dhe Denolt shpk, konstatojmë se në asnjë moment këta operatorë mbështetës nuk marrin përsipër të kryejnë vetë punët ose do t’i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

4. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotësojnë pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për paraqitjen e certifikatave të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht: Certifikatën ISO 1452-1:2009 (Sisteme rrjete tubacione kullimi dhe kanalizime) e vlefshme/ ose ekuivalent, Certifikata të jete lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën E sipas punimeve të marra përsipër në marrëveshjen e bashkëpunimit (në rastin konkret zërat (tubacione HDPE dhe Tombino betoni) që lidhen me objektin e certifikatës sipas preventivit).

Nga verifikimi I dokumentacionit të BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk, asnjëri prej anëtarëve të këtij bashkimi operatorësh nuk e posedon këtë certifikatë.

5. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotëson pikën 2.3.7 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për pajisjen me leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit, së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Referuar kontratës së bashkëpunimit (ndarja në % e punimeve), operatori ekonomik Drini 1 shpk ndër të tjera, merr përsipër të realizojë transportin e materialeve të ndërtimit nga gërmimet dhe të tjera por nuk posedon leje mjedisore kodi III.2.B për grumbullim dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme.

6. BOE Drini 1 shpk dhe Rafin Company shpk nuk plotëson pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikim të percaktuar në DT për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht për 5 (pesë) kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton 5 (pesë) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton 4 (katër) rul kompresor me vibrim gome-cilindër mbi 10 ton, 4 (katër) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton, 2 (dy) rul gome-gome mbi 8 ton .

Në nenin 88 pika 3 e VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public” thuhet “Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të percaktuara në aktmarrëveshje.”

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit vërejmë se operatori ekonomik Drini 1 shpk merr përsipër realizimin e 5.7% të zërave të punimeve, ndërsa operatori ekonomik Rafin Company shpk merr përsipër realizimin e 94.3% të tyre.

Referuar ndarjes së punime, konstatojmë se operatori ekonomik Drini 1 shpk merr përsipër të realizojë punimet si më poshtë:

- Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi >2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet, në masën 70%
- Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km, në masën 30%
- F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm
- F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=400 mm
- Struktura monolite betoni C 20/25
- Pusete shiu 40 x 40, h = 100 cm, me kapak zgare hekuri
- Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 200 cm
- Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni
- Mbingritje h=0.5 m, Pusete ekzistuese UZ Φ 1.0 m

Të gjitha punimet tjera do të realizohen nga operatori ekonomik Rafin Company shpk.

Përsa më sipër, operatori ekonomik Rafin Company shpk nuk plotëson kërkesën për mjetet që I nevojiten për realizimin e objektit të prokurimit, konkretisht ka 1 (një) kamionë/kamionçinë me kapacitet mbajtës deri 3.5 ton nga minimumi 3 (tre) që i nevojiten ka 2 (dy) rul kompresor me vibrim gome-cilindër mbi 10 ton nga 4 (katër) qe i nevojiten, ka 2 (dy) rul kompresor me vibrim gome-cilindër deri 6 ton nga 4 (katër) që i nevojiten, ka 1 (një) rul gome-gome mbi 8 ton nga 2 (dy) që i nevojiten.

Ndërsa operatori ekonomik Drini 1 shpk nuk ka asnjë kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton nga 5 (pesë) që i nevojiten.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, **SHKELQIMI 07 shpk**, NIPT K68121808W, me adresë *Fier Qender - MALLAKASTER BELISHOVE Fshati Belishov, rruga nacionale "Ballsh Fier", zona kadastrale 1143 numer pasurie 186/7* se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 234,766,980 (dyqind e tridhjetë e kater milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashte mije e nëntëqind e tetëdhjetë) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.